REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

"DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 TË BASHKISË SHKODËR"

Konsultim publik : Njësia administrative: Dajç.

Data : *16.09.2026* **Ora** : *13.00* **Vendi:** *Pranë Komunës.*

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesmarrësve 27, nga të cilat 7 gra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft-projekt planin buxhetor afatmesem 2027-2029 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- Projekt-aktin e propozuar
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- Ju dha fjalën pjesëmarrësve

I. Paraqitja e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe projektbuxhetit

Takimi u hap nga **z. Oltion Luli,** Kryetar i Këshillit Bashkiak Shkodër, i cili sqaroi se qëllimi i këshillimit ishte marrja e mendimeve dhe propozimeve të banorëve për nevojat dhe prioritetet që duhet të reflektohen në planifikimin buxhetor të vitit 2027 dhe në PBA 2027-2029.

Në paraqitje u kërkua që diskutimet të fokusoheshin te funksionet dhe shërbimet e Bashkisë Shkodër, përfshirë infrastrukturën rrugore, ndriçimin publik, pastrimin dhe menaxhimin e mbetjeve, ujësjellës-kanalizimet, kanalet kulluese e vaditëse, objektet arsimore dhe shëndetësore,

shërbimet sociale dhe nevojat e tjera të komunitetit. Pjesëmarrësit u ftuan të përcaktonin prioritetet kryesore për zonat e tyre.

Në vijim, **z. Marjan Ndershtiqaj** dhe administratori i njësisë **z. Broz Pjetrani** kërkuan që problematikat të paraqiteshin në mënyrë të përmbledhur dhe të orientoheshin te prioritetet e realizueshme për vitin pasardhës.

II. Diskutimet, kërkesat dhe propozimet

Z. Broz Pjetrani, administrator i Njësisë Administrative Dajç: Vlerësoi ndërhyrjet në kanalet kulluese, por theksoi se rrjeti është i gjerë dhe ka ende nevojë për pastrime e mirëmbajtje, përfshirë kanalet e treta.

Znj. Albina, drejtuese e shkollës në Dajç: Evidentoi gjendjen e rënduar të godinës së shkollës, oborrit dhe kanaleve përreth. Kërkoi rikonstruksion të plotë, duke përmendur suvatimet, lyerjen, rrethimin, klasat dhe tualetet si problematika urgjente.

Z. Gëzim Metalaj: Kërkoi hapjen/pastrimin e kanalit në zonën e Mushanit, i cili sipas tij nuk ishte trajtuar prej shumë vitesh.

Banor i Darragjatit: Kërkoi bonifikimin dhe sistemimin e tokave, si dhe ndërhyrje për energjinë elektrike dhe ndriçimin publik.

Z. Vitor Lakaj, kryeplak i Samrishtit: Kërkoi rrugë për Samrishtin e Ri dhe zgjidhje për kanalizimet e ujërave të zeza.

Z. Alfred Macorri, kryetar i fshatit Pentar: Kërkoi pastrimin e kolektorit, ndërtimin/riparimin e urave të nevojshme, sistemimin e hyrjes së fshatit dhe të rrugës Pentar-Ças, si dhe ndërhyrje ndaj problematikave me OSHEE-në.

Z. Gëzim Metalaj, kryeplak i fshatit Mushan: Kërkoi ndërhyrje në rrugën Mlloja dhe rrugën e lagjes, ndriçimin e rrugës së shkollës, pastrimin e kanaleve, përmirësimin e ujit të pijshëm dhe ndërhyrjen te Ura e Lleshit.

Z. Mati Tonçaj: Kërkoi verifikim dhe ndërhyrje për dy plepa që, sipas tij, paraqesin rrezik për banesën.

Z. Tom Pjetrani, kryetar i fshatit Samrisht i Vjetër: Kërkoi që në takime të përfshihej edhe OSHEE-ja, ndërhyrje në rrugën e fshatit dhe shtimin e ndriçimit publik.

Z. Shaban Shabani: Ngriti problemin e tensionit të ulët të energjisë elektrike në zonën pranë varrezave të Shirqit.

Z. Marash Mali, Suka-Dajç: Kërkoi pastrimin dhe funksionalizimin e kanalit vaditës, rreth 15 ndriçues dhe vijëzimin e rrugës kryesore.

Pjesëmarrës nga zona e Shirqit: Kërkuan funksionim më të plotë të shërbimit shëndetësor gjatë ditës, mirëmbajtjen e argjinaturës, sistemimin e rrugës së Mirucëve dhe aksesit drejt kishës së Shna Prendes, si dhe ndriçim rrugor.

Z. Besnik Haxhija, drejtues i qendrës shëndetësore Dajç: Sqaroi orarin e shërbimit dhe paraqiti nevojat për disa ndërhyrje të vogla në ambulancën e Mushanit dhe qendrën shëndetësore Dajç, përfshirë izolimin, furnizimin me ujë dhe derën kryesore.

Kryetari i fshatit Shirq: Kërkoi pastrime në zonë, sistemimin e ujit të vaditjes, një skemë më të qartë për sistemin e ujitjes dhe pastrimin e kanalit kufizues mes Dajçit dhe Trushit.

Z. Brahim Saiti, banor i fshatit Rrushkull: Kërkoi shqyrtimin e mundësisë për tarifimin e tokës bujqësore nga Bashkia.

III. Evidentimi i prioriteteve dhe dokumentacioni

1. Rikonstruksioni i shkollës së Dajçit dhe përmirësimi i objekteve arsimore.
2. Pastrimi dhe rehabilitimi i rrjetit të kanaleve kulluese dhe vaditëse, përfshirë Mushanin, Shirqin dhe kufirin Dajç-Trush.
3. Sistemimi i rrugëve në Samrisht, Pentar, Mushan, Shirq dhe zonat e tjera të njësisë.
4. Përmirësimi i rrjetit elektrik dhe shtimi i ndriçimit publik.
5. Forcimi i shërbimit shëndetësor, mirëmbajtja e ambulancave dhe furnizimi me ujë.
6. Mirëmbajtja e argjinaturës, urave dhe veprave të tjera të infrastrukturës mbrojtëse.
7. Trajtimi i kërkesave për ujitje, bonifikim dhe çështje që lidhen me tokën bujqësore.

Kërkesat, vërejtjet dhe propozimet e mësipërme administrohen si pjesë e dokumentacionit të këshillimit publik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe projektbuxhetin vjetor

2027. Ato pasqyrojnë ndërhyrjet dhe prioritetet e paraqitura gjatë takimit dhe nuk përbëjnë vendimmarrje të pjesëmarrësve.

SEKRETARE

Sabina Danaj

Zbardhi proces verbalin:

Bekim Mema

Irma Sulishti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË PREZENCË

KONSULTIM PUBLIK: *" PËR DRAFT PROJEKT PLANIN BUXHETOR AFATMESEM 2027-2029 TË BASHKISË SHKODËR"*

Njësia Administrative Dajç *Datë: 16.09.2026*

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1.	Viktor Loshi	Samish			
2.	Manush Vaslija	Shkoder			
3.	Mark Ivezaj	Samish			
4.	Mark Simoni	Dajç			
5.	Vincens Rroku	Pentar			
6.	Alfred Nikaj	Samish			
7.	Jelena Malaj	Balaj			
8.	ALBINË KULLA	SHKODËR			
9.	Gëzim Malaj	Mushan	Kryetar F.		
10.	Ilir Shala	DPMOP	0699611334		

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
11.	ANILA BARBULLUSHI	Dr. Kopshti	0674060881		
12.	Najade Anemali	B. Shkodër	067315161P		
13.	Milan Kopshti	Dajç	0694597055		
14.	Sweles kodra	Shirq	06967 11475		
15.	Majlinde Mandi	Dajç	0692861500	majlindemandi@gmail.com	
16.	Flaudora Lukaj	Dajç	0673224166	flaudoralukaj@gmail.com	
17.	Alfred Kocolli	Pentar	0683303869		
18.	Selfin Mlinaj	Mamurras	0682932820		
19.	ALEKSHANDER SHKODRA	DAVJA			
20	Eqrem Petroni	Kryetar Lezhë	0692310647		
21	Ensi Mëzezaj		0693163381		
22	Afrim Lobi	NSHPP	0682042990		
23	Shaban Shaba	Shkozë	0692579275		
24.	Mikaela Mirca	NSHPP	0682012325		
25	Orvin Rapo	Rrëshkadër.			
26	BESNIK HAXHIA	Q SH DAJÇ	0692516114	haxhiamik@yahoo.com	
27.	JULIAN GJERA	PENTAR	0695069618		
28.					
29.					
30.					